



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Nr. 17047 Prot

Shkodër, më 26.6.2026

Lënda: Kërkesë për shtesë rend dite

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëlidhur po ju paraqesim këtë kërkesë për shtesë rend dite në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e projekt – vendimit:

1. *“Për subvencionimin e transportit qytetës të udhëtareve në Bashkinë Shkodër”*

Duke ju uruar punë të mbarë !

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI
Z/KRYETAR
ALBAN PRËKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot.

Shkodër, më ____/____/2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë ____/____/2026

**“PËR SUBVENCIONIMIN E TRANSPORTIT QYTETËS TË UDHËTARËVE NË
BASHKINË SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës ____/____/2026, në zbatim të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, nenit 23, pika 6, nenit 30, pika 7, nenit 54, shkronja “k” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neneve 10, 12/a, 13, 14, dhe 17, të ligjit nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar; neni 4/e, të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar; të ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar; ligj 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, të ndryshuar; VKM nr.325, datë 19.3.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; Udhëzim plotësues i Ministrisë së Financave nr.2, datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”; Udhëzimit nr.5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriteve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar; VKB nr.44, datë 25.06.2025 “Për miratimin e rregullave të linjave, stacioneve të qëndrimit dhe të tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë Shkodër”; VKB nr.84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar; VKB nr.25, datë 30.03.2026 “Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Shkodër”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, si dhe relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I :

1. Të miratojë subvencionimin e transportit qytetës të udhëtarëve, në linjat Bahçallek-Fermentim-Bahçallek dhe Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër, për një periudhë 5 mujore, në shumën 8,845,780 (tetëmilion e tetëqind e dyzet e pesëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë) Lekë, nga të cilat 6,040,691 (gjashtëmilion e dyzetmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) Lekë, për linjen Bahçallek-Fermentim-Bahçallek dhe 2,805,089 (dymilion e tetëqind e pesëmijë e tetëdhjetë e nëntë) Lekë për

linjen Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër. Ky fond do kaloje ne programin AD141- Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisit, produktin V457AAB, Aktivitetin P.AD141.Q3.O1.A2: Subvencionimin e kilometrave të realizuara të transportit qytetës të udhëtarëve, në linjat Bahçallek-Fermentim-Bahçallek dhe Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër. Llogaria ekonomike 603 – Subvencion, Institucioni likuidues Bashkia Shkoder sipas fishës bashkëlidhë.

2. Subvencionimi, do të përfitohet vetëm nëse operatorët e shërbimit të transportit qytetës, do të kryejnë me mjetet e certifikuara jo më pak se 90 % të kilometrave mujore të planifikuara sipas linjave, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.
 - 2.1 Për kryerjen nga 90.00% deri në 92.99% të kilometra mujore të planifikuara, për secilën linjë, vlera e subvencionimit do të shumëzohet me koeficientin e realizimit 0,8.
 - 2.2 Për kryerjen nga 93.00% deri në 95.99% kilometra mujore të planifikuara, për secilën linjë, vlera e subvencionimit do të shumëzohet me koeficientin e realizimit 0,9.
 - 2.3 Për kryerjen nga 96.00% deri në 100% kilometra mujore të planifikuara, për secilën linjë, vlera e subvencionimit do të shumëzohet me koeficientin e realizimit 1.
 - 2.4 Subvencioni = Km realizuar x Koeficient subvencioni x koeficient realizimi
3. Pagesa e subvencionimit do të jetë mujore dhe do të kryhet pas datës 10 (dhjetë) të muajit pasardhës.
 - 3.1. Për përfitimin e subvencionimit, operatori i linjes duhet të dorëzojë brenda datës 5 (pesë) të muajit pasardhës: a) kërkesën me emërtimin e linjës, numrin Nipt, numrin e Licencës, b) Bankën dhe numrin e llogarisë; c) Raportin mujor të kilometrave me nënshkrim elektronik nga subjekti që ofron sistemin GPS të nënshkruar dhe nga vetë operatori.
4. Sektori i Transportit dhe Licencimit, monitoron shërbimin e transportit qytetës të udhëtarëve nëpërmjet sistemit GPS (Global Positionin Sistem) të vendosuar në çdo mjet të certifikuar, sipas standarteve bashkëkohore dhe kushteve të vendosura nga Bashkia Shkodër.
5. Sektori i Transportit dhe Licencimit, periodikisht monitoron në terren shërbimin e transportit qytetës të udhëtarëve. Raporti i monitorimit, duhet të jetë pjesë e dokumentacionit mujor për përfitimin e subvencionimit.
6. Sektori i Transportit dhe Licencimit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pasi kryen verifikimet dhe përlllogaritjet sipas parashikimeve të këtij vendimi dhe plotësimin e kushteve për përfitimin e subvencionimit, i përcjellë dokumentacionin Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, i përcjellë dokumentacionin financiar dhe ligjor për pagesën e subvencionimit të shërbimit të transportit qytetës të udhëtarëve, Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar.
8. Burimi i financimit për subvencionimin e kilometrave të realizuara të transportit qytetës të udhëtarëve shtesë në programin AD141- Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisit, produktin V457AAB, Aktivitetin P.AD141.Q3.O1.A2: Subvencionimi i kilometrave të realizuara të transportit qytetës të udhëtarëve, në linjat Bahçallek-Fermentim-Bahçallek dhe Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër, Llogaria ekonomike 603 – Subvencion, Institucioni likuidues Bashkia Shkodër do të jetë rialokimi i fondeve të trashëguara nga viti 2025 ndërmjet programeve sipas tabelave të mëposhtme

Pakësim të trashëguara viti 2025

Vlera në lekë

PROGRA MI	PRODUKTI	Aktiviteti	KAPITUL LI	LLOGARIA EKONOMI KE	SHUMA	Institucioni
AB141 Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile	V314AAB	P.AB141.Q1.O1.A2 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake & të trashëguara	1	602 Shpenzime operative	875,014	Bashkia Shkodër
		P.AB141.Q1.O1.A3 Telekomunikim për policinë bashkiake			15,000	
		P.AB141.Q1.O1.A4 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake - & të trashëguara			246,106	
		P.AB141.Q1.O1.A5 Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë bashkiake & të trashëguara			120,000	
		P.AB141.Q1.O1.A6 Kamera sigurie(CCTV) per ambjente publike dhe mirembajtja e tyre. & të trashëguara			357,344	
AF141 Kulturë Sport Argëtim	V823AAB	P.AF141.Q2.O3.A18 Aktivitete ne partneritet me te trete	1	604 Transferime të brendshme	20,516	Bashkia Shkodër
	V823AAA	P.AF141.Q2.O3.A1 Paga dhe sigurime te personelit te Teatrit "Migjeni" dhe Kinema Republika		606 Transfertë individuale	676,980	
AB141 Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile	V091AAB	P.AB141.Q2.O1.A2.Furni zim me karburant ne funksion te emergjencave civile	5	602 Shpenzime operative	562	Bashkia Shkodër
AD141 Planifikimi dhe Kontrolli Territorit dhe Mjedisit	V457AAB	P.AD141.Q3.O1.A1: Pensioniste, studente apo grupe tjera ne nevoje te subvencionuar & të trashëguara		603 Subvencion	705,064	
AF141 Kulturë Sport Argëtim	V823AAC	P.AF141.Q2.O3.A21 Realizim I aktiviteve te Teatrit Migjeni e të trashëguara		602 Shpenzime operative	1,252,924	
		P.AF141.Q2.O3.A21 Realizim I aktiviteve te Teatrit Migjeni e të trashëguara		604 Transferime të brendshme	2,271,752	
	V813AAB	P.AF141.Q1.O1.A3. Aktivitete rinore dhe sportive Shkodra ,qyteti			10	

		europian i sportit 2025 e të trashëguara				
	V823AAB	P.AF141.Q2.O3.A18 Aktivitete ne partneritet me te trete			9,000	
Totali Bashkia					6,550,272	
AE141 Shërbime Publike Vendore	V457AAA	P.AE141.Q3.O1.A4. Permiresimi i Sinjalistikes Horizontale dhe Vertikale ne segmentet kryesore e të trashëguara	1	231 Shpenzime kapitale të trupëzuara	39,708	NSHPP
		P.AE141.Q3.O1.A3. Levizshmëria dhe sinjalistika e të trashëguara			111,767	
		P.AE141.Q3.O1.A1: Paga dhe sigurime te stafit e të trashëguara	5	602 Shpenzime operative	8,783	
		P.AE141.Q3.O1.A2: Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit e të trashëguara			54,830	
		P.AE141.Q3.O1.A3: Levizshmëria dhe sinjalistika e të trashëguara			2,080,420	
Totali NSHPP					2,295,508	
TOTALI BASHKIA+NSHPP					8,845,780	

Shtesë viti 2026

Vlera në lekë

PROGRAMI	PROD UKTI	Aktiviteti	KAPITULLI	LLOGARIA EKONOMIKE	SHUMA	Institucioni
AD141 Planifikimi dhe Kontrolli Territorit dhe Mjedisit	V457A AB	P.AD141.Q3.O1.A2: Subvencionim e kilometrave të realizuara të transportit qytetës të udhëtarëve, në linjat Bahçallek-Fermentim-Bahçallek dhe Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër	1	603 Subvencion	2,350,668	Bashkia Shkodër
			5		6,495,112	
		TOTALI			8,845,780	

Nr.	Aktivitetin P.AD141.Q3.O1.A2: Subvencionim e kilometrave të realizuara të transportit qytetës të udhëtarëve, në linjat Bahçallek-Fermentim- Bahçallek dhe Shkodër- Shirokë-Zogaj-Shkodër	Programi AD141- Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedis
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Shërbimi urban qytetës realizohet në dy linja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Linja Bahçallëk- Fermentim- Bahçallëk. • Linja Shkodër- Shirokë- Zogaj-Shkodër. <p>Situata e vlerësuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kosto e lartë për ofrimin e shërbimit • Flotë e vjetër e autobusëve • Trafik i rënduar në akse të ndryshme, i cili redukton shpejtësinë e transportit urban, si dhe ndikon negativisht në respektimin e frekuencave, duke demotivuar rrjedhimisht qytetarët në përdorimin e tij. • Zënia e vendqëndrimeve nga parkimi i jashtëligjshëm i automjeteve. • Informaliteti që cënon transportin e rrjetit urban dhe linjave të rregullta 		
Linja BAHÇALLEK – FERMENTIM – BAHÇALLEK		
Stacionet		
<p>Në vajtje: Bahçallek, Kisha e Zojës, Ura e Bunës, Bexhisteni, Medreze, Fund Xhabije, Xhabije, shkolla "Ndre Mjeda", Sheshi "Parrucë", Sheshi "Demokracia", Biblioteka e Universitetit, Sheshi "Rus", Sheshi "Prekë Cali", Spitali Rajonal, Gjimnazi "Arben Broci", ish-Uzina e Telave, Fermentim.</p>		
<p>Në kthim: Fermentim, ish-Uzina e Telave, Gjimnazi "Arben Broci", Spitali Rajonal, Sheshi "Prekë Cali", Sheshi Rus, Shkolla e Muzikës, Biblioteka e Universitetit, Sheshi "Demokracia" (në fillim të rrugës "Qemal Draçini"), Biblioteka "Marin Barleti", dalja shkolla "Ndre Mjeda", Xhabijej (dalja Tophanë), Fund Xhabijej, Bexhisteni, Ura e Bunës, Kisha e Zojës, Bahçallek.</p>		
Orari i fillimit dhe mbarimit të shërbimit		
Nga ora 6:00 deri në ora 22:00		
Frekuenca e kryerjes së shërbimit		
Frekuencat e lëvizjes, do të përcaktohen me urdhër Kryetarit të Bashkisë, sipas kërkesave të lëvizjes së popullsisë.		
Llogaritja e subvencionit		
<p>Kushtet për përfitimin e subvencionit Subjektet e licencuara për transportin qytetës të udhëtarëve, për të përfituar subvencionim e shërbimit, duhet të kryejnë me mjetet e certifikuar jo më pak se 90 % të kilometrave mujore të planifikuara me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.</p> <p>Në rastet e punimeve në rrugë, të aktiviteteve sportive, kulturore, sociale apo raste të tjera që ndikojnë në bllokimin e qarkullimit rrugor, dhe që nuk varen nga operatori i linjës, por që ndikojnë në mosrealizimin e kilometrave të miratuara, Sektori i Transportit dhe Licencimit, vlerëson dhe rillogarit kilometrat e miratuara, duke zbritur kilometrat ditore të planifikuara dhe të operuara, të ditës, të cilat kanë qenë të pamundura për tu operuar.</p> <p>Në rastin kur operatori i transportit qytetës, kryen më pak se 90% të kilometrave mujore të planifikuara, nuk përfiton subvencionim</p> <p>Formula e subvencionimit përfshin: Km e realizuara nga operatori i linjës shumëzuar me koficientin e subvencionimit, shumëzuar</p>		

me koeficientin e realizimit. Koeficienti i subvencionit, përlogaritet si vlera e munguar për të mbuluar koston e linjës, pjesuar me Km totale të linjës. Koeficienti i realizimit, llogaritet në bazë të Km reale që kryen operatori pjesuar me Km totale të linjës. Koeficientat e realizimit janë si në vazhdim: më pak se 90% të km koeficienti është 0; nga 90% deri në 92.99% është 0.8; nga 93% deri në 95.99% është 0.9 dhe nga 96% deri në 100% është 1.

Analiza e kostos :

Në analizën e bërë (periudha e monitorimit) për linjën "Bahçallëk-Fermentim-Bahçallëk", me gjatësi 14.67 km (vajtje-ardhje), kostoja 5 mujore e operimit është 11 891 411 (Njembdhjete milion e teteqindenedhjete e nje mije e katerqinde e njembdhjete) lekë, ndërkohë që operatori nga shitja e biletave ka një të ardhur 5 mujore 5 850 720 (pesëmilion e tetëqindpesëdhjetëmijë e shtatëqindenjëzët) lekë. Për mbajtjen në funksion të shërbimit, sipas analizave të bëra, është i nevojshëm një subvencionim në vlerën 6,040,691 (gjashtëmilion e dyzetmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) Lekë për periudhën 5 mujore për linjën "Bahçallëk-Fermentim-Bahçallëk"

Linja Bahçallek-Fermentim

Emertimi	Vlerë Lekë
Litra karburant	6,188,188
Taksa detyrime/shërbime	845,699
Paga sigurime personeli	3,300,000
Paga administrative	1,050,000
Amortizim	507,524
Totali i kostos	11,891,411

Emërtimi	Gjendja faktike ne leke
Pasagjer 5 muaj	146,268
Pasagjer ditor	956
Të ardhura per 5 muaj	5,850,720
Vlera e munguar qe do subvencionohet	6,040,691

Formula e subvencionit

1) **Subvencioni = (Koeficient subvencioni x koeficient realizimi x Km realizuar)**

2) **Koeficienti i subvencionit = Vlera e munguar/Km. total**

Vlera e munguar = 6,040,691

Kilometra total = 74,694.5

6,040,691/ 74,694.54 = 80.8 (koeficienti i subvencionit)

3) **Koeficienti i realizimit = Km. real / Km. total**

Koeficient realizimi	% km realizuar
0	>90%
0.8	90% - 92.99%
0.9	93% - 95.99%
1	< 96%

Linja Bahçallek-Fermentim-Bahçallek = 14 939.3 km/muaj

Masa e subvencionit per 5 muaj eshte 6 040 691 leke

Linja SHKODËR – SHIROKË – ZOGAJ – SHKODËR**Stacionet**

Në vajtje: Hotel "Rozafa" (përballë), Biblioteka "Marin Barleti", shkolla "Ndre Mjeda", Xhabijej (dalja Tophanë), Fund Xhabijej, Bexhisteni, Ura e Vjetër e Bunës, Ura e Re e Bunës (dalje), Ura e Vjetër e Bunës (rruga "Shiroka"), Shirokë, Zogaj (pranë Xhamisë)

Në kthim: Zogaj (pranë Xhamisë), Shirokë, Ura e Vjetër e Bunës (rruga "Shiroka"), Ura e Re e Bunës (hyrje), Ura e Vjetër e Bunës, Bexhisteni, Fund Xhabije, Xhabije, shkolla "Ndre Mjeda", Sheshi "Parrucë", Hotel "Rozafa"

Orari i fillimit dhe mbarimit të shërbimit

Nga ora 06:00 – 15:30 për periudhen 16 Shtator – 14 Qershor

Nga ora 07:30 – 19:30 për periudhen 15 Qershor – 15 Shtator,

Frekuenca e kryerjes së shërbimit

Frekuenca të lëvizjes, do të përcaktohen me urdhër Kryetarit të Bashkisë, sipas kërkesave të lëvizjes së popullsisë.

Llogaritja e subvencionit**Kushtet për përfitimin e subvencionit**

Subjektet e licencuara për transportin qytetës të udhëtarëve, për të përfituar subvencionim e shërbimit, duhet të kryejnë me mjetet e certifikuara jo më pak se 90 % të kilometrave mujore të planifikuara me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

Në rastet e punimeve në rrugë, të aktiviteteve sportive, kulturore, sociale apo raste të tjera që ndikojnë në bllokimin e qarkullimit rrugor, dhe që nuk varen nga operatori i linjës, por që ndikojnë në mosrealizimin e kilometrave të miratuara, Sektori i Transportit dhe Licencimit, vlerëson dhe rillovarit kilometrat e miratuara, duke zbritur kilometrat ditore të planifikuara dhe të operuara, të ditës, të cilat kanë qenë të pamundura për tu operuar.

Në rastin kur operatori i transportit qytetës, kryen më pak se 90% të kilometrave mujore të planifikuara, nuk përfiton subvencionim

Formula e subvencionimit përfshin: Km e realizuara nga operatori i linjës shumëzuar me koeficientin e subvencionimit, shumëzuar me koeficientin e realizimit. Koeficienti i subvencionit, përlllogarit si vlera e munguar për të mbuluar koston e linjës, pjesuar me Km totale të linjës. Koeficienti i realizimit, llogaritet në bazë të Km reale që kryen operatori pjesuar me Km totale të linjës.

Koeficientat e realizimit janë si në vazhdim: më pak se 90% të Km koeficienti është 0; nga 90% deri në 92.99% është 0.8; nga 93% deri në 95.99% është 0.9 dhe nga 96% deri në 100% është 1.

Analiza e koston :

Në analizën e bërë (periudha e monitorimit) për linjën "Bahçallëk-Fermentim-Bahçallëk me gjatësi 27.5 km (vajtje-ardhje) kostoja 5 mujore e operimit është 4 182 089 (katërmilion e njëqind e tetëdhjetë e dymijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë, ndërkohë që operatori nga shitja e biletave ka një të ardhur 5 mujore 1 377 000 (njëmilion e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë, sipas analizave të bëra, është i nevojshëm një subvencionim në 2,805,089 (dy milion tetëqind e pesëmijë e tetëdhjetë e nëntë) Lekë, për linjën "Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër"**Linja**

Linja Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër

Emertimi	Vlerë Lekë
Litra karburant	1,530,719
Taksa detyrime/shërbime	336,044
Paga sigurime personeli	1,100,000
Paga administrative	1,050,000
Amortizim	165,326
Totali i koston	4,182,089

Emërtimi	Gjendja faktike ne leke
Pasagjer 5 muaj	13,770
Pasagjer ditor	90
Të ardhura per 5 muaj	1,377,000
Vlera e munguar qe do subvencionohet	2,805,089

Formula e subvencionit

1) **Subvencioni = (Koefficient subvencioni x koefficient realizimi x Km realizuar)**

2) **Koefficienti i subvencionit = Vlera e munguar/Km. total**

Vlera e munguar = 2,805,089

Kilometra total = 20,911

$2,805,089 / 20,911 = 134.1$ (koefficienti i subvencionit)

3) **Koefficienti i realizimit = Km. real / Km. total**

Koefficient realizimi	% km realizuar
0	>90%
0.8	90% - 92.99%
0.9	93% - 95.99%
1	< 96%

Linja Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër = 4 182:2 km/muaj

Masa e subvencionit per 5 muaj eshte 2 805 089 leke

ii. Synimi i projektit

- Funksionimi i linjave urbane ekzistuese dhe i linjave të reja.
- Përcaktimi i vendqëndrimeve në përshtatje me studimin e planit të trafikut.
- Mbështet lëvizshmërinë e asaj kategorie udhëtarësh (punonjës, nxënës, student, të moshuar, PAK, vizitorë) që varen nga transporti publik;
- Redukton përdorimin e panevojshëm të automjeteve private, duke ndikuar drejtëpërsëdrejti në cilësinë e ajrit, në uljen e numrit të aksidenteve, në gjetjen më lehtësisht të parkimit pa pagesë, etj
- Përmirëson aksesin në transport drejt zonave prodhuese si "Zona Industriale" ku ndodhen ndërmarrje të shumta që punësojnë një numër të konsiderueshëm punonjësish si dhe drejt zonës turistike Shirokë–Zogaj, etj.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Ofrimi i shërbimit cilësor të transportit qytetës të udhëtarëve
- Monitorimi për zbatimin e frekuencave, orareve, vendqëndrimeve, në përputhje me kontratat e nënshkruara me operatorët, për secilën linjë sipas përcaktimeve të Urdhëresave dhe në sistemin e monitorimit të miratuar.

b) Rezultatet që prisni

- Funksionim normal të linjave ekzistuese.
- Shtim të përdoruesve të transportit urban, nëpërmjet respektimit rigoroz të cikleve dhe orareve.
- Zbatimi dhe nxitja e mëtejshme e politikave favorizuese ndaj shtresave në nevojë.

<ul style="list-style-type: none"> Një qytet me ajër më të pastër, me njerëz më aktivë e më të shëndetshëm, si dhe më të sigurtë nga aksidentet. 						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështëse			Bashkia e Shkodrës			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Subvencion
A.1	Subvencionimi i kilometrave të realizuara në transportin qytetës të udhëtarëve, në linjat Bahçallek-Fermentim-Bahçallek dhe Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër	8 845 780			8 845 780	
Shuma 2026		8 845 780			8 845 780	
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit Institucioni likujdues: Bashkia Shkoder				

9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.


KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Alban PREKA



ZV/KRYETAR

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHERBIMEVE MBËSHTETESE

DREJTORIA JURIDIKE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TE TERRITORIT

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

DIONIS DRAGANI

DREJTORIA E PERGJITHSHME E MENAXHIMIT FINANCIAR

ELVIN BRAHIMI

DREJTORIA E ANALIZES DHE PROGRAMIT BUXHETOR

DREJTORIA E FINANCES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Nr. _____ Prot.

Shkodër, më ____/____/2026

RELACION:

“PËR SUBVENCIONIMIN E TRANSPORTIT QYTETËS TË UDHËTARËVE NË BASHKINË SHKODËR”

I. Transporti qytetës i udhëtarëve

Na Bashkinë Shkodër, të miratuara me vendim të këshillit të bashkisë, janë 4 (katër) linja të transportit qytetës të udhëtarëve, respektivisht Bahçallek-Fermentim-Bahçallek, Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër, Kiras-Stacioni i Trenit-Rrethrotullimi Tepe-Kiras dhe Shërbimi Urban në Unazë. Deri më tani, ky shërbim ofrohet vetëm në dy linja, Bahçallek-Fermentim-Bahçallek dhe Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër, nga operator privat me të cilët, Bashkia Shkodër ka lidhë marrëveshje. Për dy linjat e tjera, Kiras-Stacioni i Trenit-Rrethrotullimi Tepe-Kiras dhe Shërbimi Urban në Unazë, deri më tani nuk ka patur interes nga operator privat. Një shërbim efikas dhe brenda standarteve bashkëkohore të transportit, ndikon pozitivisht në lëvizshmërinë dhe kursim kohe të qytetarëve, por dhe në uljen e trafikut të automjeteve në rrugë, në cilësinë e ajrit, në uljen e aksidenteve etj. Pavarësisht se ka një përmirësim të shërbimit të transportit qytetës të udhëtarëve, çka vihet re (por dhe monitoruar) në numrin e autobusëve në qarkullim, frekuencën e lëvizjes, zbatueshmërinë e orareve të shërbimit, stacioneve të qëndrimit, sinjalistikës horizontale dhe vertikale, ky shërbim nuk është në standartet e duhura dhe të kërkuara nga qytetarët.

II. Monitorimi i transportit qytetës të udhëtarëve

Për të krijuar një panoramë të funksionimit të transportit qytetës të udhëtarëve, është bërë monitorimi, kryesisht në linjën Bahçallek-Fermentim-Bahçallek, si më e përdorur nga qytetarët dhe me numër xhirosh ditore dhe kohëzgjatje shërbimi më të madhe se ajo Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër. Monitorimi, është bërë në periudha të ndryshme në 2024, 2025 dhe së fundmi në mars-prill-maj 2026. Meqenë se, Sektori i Transportit dhe Licencimit, u plotësua me personel në janar 2026, monitorimi i fundit, përveç kontrollit të zbatueshmërisë së frekuencës, orareve, itinerarit, numrit të udhëtarëve, kushteve në autobus dhe të çdo elementi tjetër që ndikon në mbarëvajtjen e këtij shërbimi, u krye dhe për të krijuar një panoramë të kostos financiare për funksionimin e këtij shërbimi. Siç u citua dhe më sipër, transporti qytetës i udhëtarëve edhe pse është përmirësuar, nuk është në stradartin e duhur dhe ndër arsyet kryesore janë kostoja e lartë për mbarëvajtjen e shërbimit, numri i ulët i udhëtarëve (faktorët janë të ndryshëm) dhe flota e vjetër e autobusëve. Një element i thjeshtë, numri i përdoruesve në linjën Bahçallek-Fermentim-Bahçallek, nga ora 06:30 deri në 22:00 (orari kur mbyllet shërbimi në Bahçallek), me 45 cikle (vajtje-ardhje) në ditë, është me rreth 956 udhëtarë në ditë; ndërsa në atë Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër, nga ora 06:15 deri në 15:15 (orari i fundit i nisjes nga Shkodra), me 2 cikle (vajtje-ardhje) me rreth 90 në ditë.

III. Analiza financiare dhe subvencionimi i shërbimit

Analiza financiare e transportit qytetës të udhëtarëve për dy linjat funksionale, është bërë bazuar në kushtet e vendosura në marrëveshjet midis palëve, si dhe duke marrë në konsideratë: numrin mujor të udhëtarëve për linjë; çmimin e biletës; numrin e autobusëve; konsumin e karburantit, vajrave, gomave, pjesëve të ndërrimit (referuar çmimit të tregut) etj; nivelin e pagave, të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; tatimet, taksat, tarifat, siguracionet, kontrolli teknik i mjeteve etj. Në analizën e bërë (periudha e monitorimit) për linjën “Bahçallëk-Fermentim-Bahçallëk”, me gjatësi 14.67 km (vajtje-ardhje), kostoja 5 mujore e operimit është 11 891 411 (Njembdhjete milion e teteqindenentedhjetë e nje mije e katerqinde e njembdhjete) lekë, ndërkohë që operatori nga shitja e biletave ka një të ardhur 5 mujore 5 850 720 (pesëmilion e tetëqindepesëdhjetëmijë e shtatëqindenjetë) lekë, ndërsa për linjën “Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shirokë-Shkodër”, me gjatësi 27.5 km (vajtje-ardhje) kostoja 5 mujore e operimit është 4 182 089 (katërmilion e njëqind e tetëdhjetë e dymijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë, ndërkohë që operatori nga shitja e biletave ka një të ardhur 5 mujore 1 377 000 (njëmilion e treqind e shtatëdhjetë e shtatëmijë) lekë. Për mbajtjen në funksion të shërbimit, sipas analizave të bëra, është i nevojshëm një subvencionim në vlerën 6,040,691 (gjashtëmilion e dyzetmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) Lekë për periudhën 5 mujore për linjën “Bahçallëk-Fermentim-Bahçallëk” dhe në vlerën 2,805,089 (dy milion tetëqind e pesëmijë e tetëdhjetë e nëntë) Lekë, për linjën “Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër”. Që linjat e transportit publik në Bashkinë Shkodër të ofrojnë një shërbim sa më cilësor dhe sipas standarteve për qytetarët, është i nevojshëm një subvencion pesëmujor total në vlerën 8,845,780 (tetëmilion e tetëqind e dyzetepesëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë) Lekë,

Në mënyrë më të detajuar, analiza e kostove të shërbimit të transportit qytetës, do të jetë si më poshtë.

Linja Bahçallek-Fermentim

Emertimi	Vlerë Lekë
Litra karburant	6,188,188
Taksa detyrime/shërbime	845,699
Paga sigurime personeli	3,300,000
Paga administrative	1,050,000
Amortizim	507,524
Totali i kostos	11,891,411

Emertimi	Gjendja faktike ne leke
Pasagjer 5 muaj	146,268
Pasagjer ditor	956
Të ardhura per 5 muaj	5,850,720

Vlera e munguar qe do subvencionohet	6,040,691
---	------------------

Linja Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër

Emertimi	Vlerë Lekë
Litra karburant	1,530,719
Taksa detyrime/shërbime	336,044
Paga sigurime personeli	1,100,000
Paga administrative	1,050,000
Amortizim	165,326
Totali i kostos	4,182,089

Emërtimi	Gjendja faktike ne leke
Pasagjer 5 muaj	13,770
Pasagjer ditor	90
Të ardhura per 5 muaj	1,377,000
Vlera e munguar qe do subvencionohet	2,805,089

IV. Përse është i nevojshëm subvencionimi

Siç u citua dhe më sipër, transporti qytetës i udhëtarëve është një element i rëndësishëm i jetës së përditëshme të qytetit, pasi një mirëfunksionim i tij do të ndikonte pozitivisht në aspektin social, ekonomik dhe mjedisor për banorët dhe qytetin, më konkretisht:

- mbështet lëvizshmërinë e asaj kategorie udhëtarësh (punonjës, nxënës, student, të moshuar, PAK, vizitorë) që varen nga transporti publik;
- redukon përdorimin e panevojshëm të automjeteve private, duke ndikuar drejtëpërsëdrejti në cilësinë e ajrit, në uljen e numrit të aksidenteve, në gjetjen më lehtësisht të parkimit pa pagesë, etj
- përmirëson aksesin në transport drejt zonave prodhuese si “Zona Industriale” ku ndodhen ndërmarrrje të shumta që punësojnë një numër të konsiderueshëm punonjësish si dhe drejt zonës turistike Shirokë–Zogaj, etj.

Për ti dhënë një impuls dhe frekuentim më të madh zonave turistike Shirokë dhe Zogaj, nisur dhe nga ndërtimi i aksit rrugor Shirokë-Zogaj u propozua një orar fillimi dhe mbarimi të shërbimit për linjën “Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër”, nga 06:00 deri në 19:30, por i ndryshueshëm sipas

muajve, respektivisht 15 Qershor-15 Shtator nga 07:30 deri në 19:30 dhe 16 Shtator-14 Qershor nga ora 06:00 deri në ora 15:30.

Por, për të pasur një shërbim brenda standarteve bashkëkohore dhe që mbulon nevojat e banorëve për transport qytetës me frekuenca dhe orare, nisur dhe nga numri i përdoruesve prej rreth 956 udhëtarë në ditë për linjën “Bahçallëk-Fermentim-Bahçallëk” dhe 90 udhëtarë në ditë për linjën “Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër”, është mëse i domosdoshëm subvencionimi i këtij shërbimi. Subvencionimi i transportit qytetës të udhëtarëve, është një praktikë që ndiqet dhe nga njësi vendore të tjera të vendit tonë.

V. Kushtet për përfitimin e subvencionit

Subjektet e licencuara për transportin qytetës të udhëtarëve, për të përfituar subvencionim e shërbimit, duhet të kryejnë me mjetet e certifikuara jo më pak se 90 % të kilometrave mujore të planifikuara me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

Në rastet e punimeve në rrugë, të aktiviteteve sportive, kulturore, sociale apo raste të tjera që ndikojnë në bllokimin e qarkullimit rrugor, dhe që nuk varen nga operatori i linjës, por që ndikojnë në mosrealizimin e kilometrave të miratuara, Sektori i Transportit dhe Licencimit, vlerëson dhe rillogarit kilometrat e miratuara, duke zbritur kilometrat ditore të planifikuara dhe të operuara, të ditës, të cilat kanë qenë të pamundura për tu operuar.

Në rastin kur operatori i transportit qytetës, kryen më pak se 90% të kilometrave mujore të planifikuara, nuk përfiton subvencionim

Formula e subvencionimit përfshin: Km e realizuara nga operatori i linjës shumëzuar me koficientin e subvencionimit, shumëzuar me koficientin e realizimit. Koficienti i subvencionit, përllogaritet si vlera e munguar për të mbuluar koston e linjës, pjesuar me Km totale të linjës. Koficienti i realizimit, llogaritet në bazë të Km reale që kryen operatori pjesuar me Km totale të linjës.

Koficientat e realizimit janë si në vazhdim: më pak se 90% të km koficienti është 0; nga 90% deri në 92.99% është 0.8; nga 93% deri në 95.99% është 0.9 dhe nga 96% deri në 100% është 1.

Formula e subvencionit

1) **Subvencioni = (Koficient subvencioni x koficient realizimi x Km realizuar)**

2) **Koficienti i subvencionit = Vlera e munguar/Km. total**

Vlera e munguar = 6,040,691

Kilometra total = 74,694.5

$6,040,691 / 74,694.54 = 80.8$ (koficienti i subvencionit) Bahçallek-Fermentim-Bahçallek

Vlera e munguar = 2,805,089

Kilometra total = 20,911

$2,805,089 / 20,911 = 134.1$ (koficienti i subvencionit) Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër

3) **Koficienti i realizimit = Km. real / Km. total**

Koficient realizimi	% km realizuar
0	>90%
0.8	90% - 92.99%

0.9	93% - 95.99%
1	< 96%

Linja Bahçallek-Fermentim-Bahçallek = 14 939.3 km/muaj
Linja Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër = 4 182.2 km/muaj

Shembull 1 Linja Bahçallek-Fermentim-Bahçallek

Linja realizon 91% të kilometrave mujor

Subvencioni = $80.8 \times 0.8 \times 13,595$ (km realizuar muaj) = 878,780.8 lekë.

Shembull 2 Linja Bahçallek-Fermentim-Bahçallek

Linja realizon 99% të kilometrave mujor

Subvencioni = $80.8 \times 1 \times 14,939$ (km realizuar muaj) = 1,207,071.2 lekë

Verifikimi i kilometrave të kryera, do të bëhet nëpërmjet sistemit GPS (Global Positionin Sistem) , të operatorëve, të cilët duhet ta kenë të instaluar në çdo autobus. Ky sistem, duhet të jenë sipas standarteve bashkëkohore, të vendosura nga subjekte të licencuara, sipas kushteve të vendosura nga Bashkia Shkodër. Sistemi GPS, duhet të gjeneroj raportin ditor dhe mujor të kilometrave të kryera nga çdo autobus, targën e tyre dhe emrin e linjës. Monitorimi i shërbimit të transportit qytetës të udhëtarëve, do të bëhet në kohë reale dhe periodike, nga Sektori i Transportit dhe Licencimit, nëpërmjet sistemit GPS, sipas rregullave që do të vendosen. Transporti qytetës i udhëtarëve do të monitorohet periodikisht në terren nga Sektori i Transportit dhe Licencimit. Raporti i monitorimit, do të jetë pjesë e dokumentacionit mujor për përfitimin e subvencionimit.

Për të përfituar subvencionimin, operatori i transportit duhet të dorëzojë pranë Sektorit të Transportit dhe Licencimit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Shkodër, brenda datës 5 (pesë) të muajit pasardhës: a) kërkesën me emërtimin e linjës, numrin Nipt, numrin e Licencës, b) Bankën dhe numrin e llogarisë; c) Raportin mujor të kilometrave me nënshkrim elektronik nga subjekti që ofron sistemin GPS e nënshkruar dhe nga vetë operatori.

Sektori i Transportit dhe Licencimit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pasi kryen verifikimet dhe përlllogaritjet sipas parashikimeve të këtij vendimi dhe plotësimin e kushteve për përfitimin e subvencionimit, e përcjellë dokumentacionin tek Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, i përcjellë dokumentacionin financiar dhe ligjor për pagesën e subvencionimit të shërbimit të transportit qytetës të udhëtarëve, Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar.

VI. Burimi i financimit

Burimi i financimit për subvencionimin e kilometrave të realizuara të transportit qytetës të udhëtarëve shtesë në programin AD141- Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisit, produktin V457AAB, Aktivitetin P.AD141.Q3.O1.A2: Subvencionimi i kilometrave të realizuara të transportit qytetës të udhëtarëve, në linjat Bahçallek-Fermentim-Bahçallek dhe Shkodër-Shirokë-Zogaj-Shkodër, Llogaria ekonomike 603 – Subvencion, Institucioni likuidues Bashkia

Shkodër do të jetë rialokimi i fondeve të trashëguara nga viti 2025 ndërmjet programeve sipas tabelave të mëposhtme

Pakësim të trashëguara viti 2025

Vlera në lekë

PROGRA MI	PRODUKTI	Aktiviteti	KAPITULL I	LLOGARIA EKONOMIK E	SHUMA	Institucioni
AB141 Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile	V314AAB	P.AB141.Q1.O1.A2 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake & të trashëguara	1	602 Shpenzime operative	875,014	Bashkia Shkodër
		P.AB141.Q1.O1.A3 Telekomunikim për policinë bashkiake			15,000	
		P.AB141.Q1.O1.A4 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake - & të trashëguara			246,106	
		P.AB141.Q1.O1.A5 Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë bashkiake & të trashëguara			120,000	
		P.AB141.Q1.O1.A6 Kamera sigurie(CCTV) per ambiente publike dhe mirembajtja e tyre. & të trashëguara			357,344	
AF141 Kulturë Sport Argëtim	V823AAB	P.AF141.Q2.O3.A18 Aktivitete ne partneritet me te trete		604 Transferim e të brendshme	20,516	
	V823AAA	P.AF141.Q2.O3.A1 Paga dhe sigurime te personelit te Teatrit		606 Transfertë	676,980	

		“Migjeni” dhe Kinema Republika		individuale	
AB141	V091AAB	P.AB141.Q2.O1.A2.Fu rnizim me karburant ne funksion te emergjencave civile		602 Shpenzime operative	562
AD141	V457AAB	P.AD141.Q3.O1.A1: Pensioniste, studente apo grupe tjera ne nevoje te subvencionuar & të trashëguara		603 Subvencion	705,064
AF141	V823AAC	P.AF141.Q2.O3.A21 Realizim I aktiviteve te Teatrit Migjeni e të trashëguara	5	602 Shpenzime operative	1,252,924
		P.AF141.Q2.O3.A21 Realizim I aktiviteve te Teatrit Migjeni e të trashëguara			2,271,752
	V813AAB	P.AF141.Q1.O1.A3. Aktivitete rinore dhe sportive Shkodra ,qyteti europian i sportit 2025 e të trashëguara		604 Transferim e të brendshme	10
	V823AAB	P.AF141.Q2.O3.A18 Aktivitete ne partneritet me te trete			9,000
Totali Bashkia					6,550,272

AE141 Shërbime Publike Vendore	V457AAA	P.AE141.Q3.O1.A4. Permiresimi i Sinjalistikes Horizontale dhe Vertikale ne segmentet kryesore e të trashëguara	1	231 Shpenzime kapitale të trupëzuara	39,708	NSHPP
		P.AE141.Q3.O1.A3. Levizshmëria dhe sinjalistika e të trashëguara			111,767	
		P.AE141.Q3.O1.A1: Paga dhe sigurime te stafit e të trashëguara			8,783	
		P.AE141.Q3.O1.A2: Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit e të trashëguara	5	602 Shpenzime operative	54,830	
		P.AE141.Q3.O1.A3: Levizshmëria dhe sinjalistika e të trashëguara			2,080,420	
Totali NSHPP					2,295,508	
TOTALI BASHKIA+NSHPP					8,845,780	

Shtesë viti 2026

Vlera në lekë

PROGRAMI	PROD UKTI	Aktiviteti	KAPITULLI	LLOGARIA EKONOMIKE	SHUMA	Institucion i
AD141 Planifikimi dhe Kontrolli Territorit dhe Mjedisit	V457 AAB	P.AD141.Q3.O1.A2: Subvencionim e kilometrave të realizuara të transportit qytetës të udhëtarëve, në linjat Bahçallek-Fermentim- Bahçallek dhe Shkodër- Shirokë-Zogaj-Shkodër	1	603 Subvencion	2,350,668	Bashkia Shkodër
			5		6,495,112	
		TOTALI			8,845,780	